

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Maj, 2020**

Takime nga larg me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve


Vlerësim i arritjeve, bashkëbisedë për angazhime e detyra të reja



Për të analizuar bashkërisht situatën aktuale në tërë sistemin arsimor të Kosovës dhe për t'u koordinuar për aktivitete e angazhime të reja, SBASHK-u ka mbajtur takime të shpeshta nga larg me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve. Në hapje të njërit prej këtyre takimeve kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka ftuar pjesëmarrësit për një minutë heshtje në shenjë respekti për punën dhe përkushtimin me vite e dekada në arsim dhe në aktivitete sindikale të kolegut tonë të ndjerë Isuf Zenelaj nga Suhareka, i cili ... (faqe 4)


Takime nga larg të EI-së me sindikatat anëtare nga e tërë bota

Bashkëveprim i angazhimeve në kohë të pandemisë



Internacionalja Botërore e Arsimit (EI) numëron 32 milionë anëtarë nga e tërë bota. Ajo ka ... (faqe 6)

Vullneti për njohuri të reja i kolegëve tanë për çdo respekt
Angazhime e aktivitete
edhe në ditët e vikendit e të festës



Shumë nga mësimdhënësit e Kosovës.. (faqe 10)


Intervistë me nënkryetaren e SBASHK-ut, Vjollca Shala
Janë të shumta angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë



Vjollca Shala është nënkryetare ... (faqe 3)

Organizim i suksesshëm i trajnimeve edhe me kolegët nga Dragashi

Kolegët nga kjo komunë kërkojnë të vazhdojnë me trajnimet tjera



Puna e palodhshme e stafit qendror dhe përkushtimi i trajnerëve (faqe 9)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Pak fjalë e shumë angazhime e arritje



SBASHK-u është dëshmuar vazhdimisht se krahas angazhimeve për të realizuar kërkesat legjitime sindikale të anëtarësisë është angazhuar suksesshëm edhe në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim. Derisa disa të tjerë këtë angazhimin e kishin vetëm si shprehje sa për të thënë diçka, SBASHK-u kishte pak fjalë, po bëri shumë angazhime shënoi shumë arritje.

Kjo po dëshmohet edhe tani e gjithmonë. SBASHK-u mbajti takime të vazhdueshme me anëtarësinë edhe në këtë kohë pandemie dhe i përgëzoi ata për punën e madhe në mësimin në distancë duke bashkëbiseduar me ta në gjetjen e mundësive

për tejkalimin e pengesave eventuale.

SBASHK-u krahas këtij mobilizimi në shërbim të arsimit dhe krahas shumë e shumë angazhimeve sindikale, respektoi kërkesat e anëtarësisë kudo në Kosovë dhe organizoi gjithë trajnimet e kërkuara nga ata. Trajnimet nga larg kishin rrjedhë të mbarë dhe për këtë SBASHK-u shpreh respekt për trajnerët e licencuar, për pjesëmarrësit që kanë respektuar me përpikëri orarin e trajnimeve dhe për stafin qendror që është angazhuar pa u ndalur, madje edhe në ditët e vikendeve e festave, me qëllim që trajnimet të organizohen si duhet. Ky përkushtim dha rezultate sepse trajnimet kishin rrjedhë të mbarë dhe pjesëmarrësit morën njohuri të reja, që do t'i vënë në funksion në misionin e tyre të arsimit dhe edukimit të brezave.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me nënkryetaren e SBASHK-ut, Vjollca Shala

Janë të shumta angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë



Vjollca Shala është nënkryetare e SBASHK-ut. Ajo, krahas aktiviteteve tjera sindikale, ndihmon edhe koordinatorin për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri në rrjedhën e mbarë të trajnimeve, që organizohen për punëtorët

e arsimit kudo në Kosovë. Vjollca shpesh është edhe pjesëmarrëse në taimet takimet e ETUCE e EI, si përfaqësuese e SBASHK-ut. Në këtë intervistë për gazetën “Arsimimi sot” të muajit maj nënkryetarja përgjigjet në disa pyetje që kanë të bëjnë me aktualitetin në arsimin e Kosovës.

Arsimimi sot:

Kush është Vjollca Shala?

Vjollca:

E lindur në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe shkollën e mesme e kam përfunduar në Mitrovicë. Fakultetin Elektroteknikë drejtimi Kompjuterikë me telekomunikacion në Universitetin e Prishtinës. Mastër i shkencave kompjuterike në fakultetin teknik në Tiranë. Magjistër i Informatikës në Universitetin e Tetovës. Prej viti 2001 deri në vitin 2019 mësimdhënëse e TIK-ut në Gjimnazin “Frang Bardhi” në Mitrovicë. Anëtare e SBASHK-ut menjëherë pas punësimit. Në vitin 2013 zgjidhem Kryetare e sindikatës së Gjimnazit “Frang Bardhi” në Mitrovicë. Në fund të vitit 2013 zgjidhem Nënkyetare e sindikatës së nivelit komunal të komunës së Mitrovicës. Në vitin 2014 zgjidhem Kryetare e sindikatës së nivelit komunal të komunës së Mitrovicës. Në vitin 2017 u rizgjodha kryetare e sindikatës së nivelit komunal të komunës së Mitrovicës. Në fund të vitit 2017 u zgjodha Kryetare e sindikatës së arsimit të mesëm të Kosovës. Në vitin

2018 zgjidhem nënkryetare e SBASHK-ut dhe aktualisht jam nënkryetare e SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Cili është vlerësimi juaj për mësimin nga larg?

Vjollca:

Mësimi nga larg apo mësimi emergjent është domosdoshmëri e kohës për shkak të pandemisë globale të virusit Covid-19. Dëshiroj ti përgëzoj të gjithë mësimdhënësit e Kosovës duke filluar nga çerdhet e deri në universitet për mbajtjen e mësimin nga larg edhe përkundër vështirësive të natyrave të ndryshme qoftë atyre teknike dhe ekonomike e edhe përkundër asaj që paraprakisht mësimdhënësit e Kosovës nuk kanë qenë të përgatitur për mbajtje të mësimin nga larg por, megjithatë mësimdhënësit e Kosovës janë duke e realizuar me sukses mbajtjen e mësimin nga larg.

Arsimimi sot:

Sa jeni në komunikim me anëtarësinë në këtë kohë pandemie?

Vjollca:

Menjëherë pas ndërprerjes së mësimin në objektet shkollore për shkak të pandemisë stafi i SBASHK-ut ka filluar me mbajtjen e takimeve nga larg me anëtarësinë, Kryetarët e shoqatave sindikale të të gjitha komunave të Kosovës, Kryetarët e universiteteve, Kryetarët e niveleve komunale, Kryesinë e SBASHK-ut dhe nga afër jemi njoftuar për gjendjen shëndetësore të mësimdhënësve dhe nxënësve dhe për mbarëvajtjen e mësimin nga larg. Nga MASHT-i dhe Kryetarët e komunave kemi kërkuar që familjeve me fëmijë me kushte të vështira ekonomike dhe teknike për përcjelljen e mësimin nga distanca të ju ndihmohet qoftë me paisje teknologjike apo edhe internet.

Arsimimi sot:

Krahas aktiviteteve tjera, po organizoni edhe trajnime nga larg. Na thoni dicka më shumë për këtë?

Vjollca:

Për licencim, rilicencim dhe për avancim të mësimdhënësve në karrierë mësimdhënësit duhet të kenë të përfunduar orë trajnimi, andaj SBASHK-u për të ju ndihmuar si gjithëherë anëtarësisë ka filluar me mbajtjen e trajnimeve nga larg me kërkesën e tyre. SBASHK-u ka pesë programe trajnimi të akredituara në MASHT por, katër nga këto programe trajnimi është duke i realizuar nga larg me shumë sukses me ndihmën e trajnerëve të licencuar nga SBASHK-u.

Arsimimi sot:

Jeni në komunikim të vazhdueshëm me ETUCE dhe EI. Për cka flitet më shumë në këto takime?

Vjollca:

Po jemi në komunikim të vazhdueshëm me ETUCE dhe EI dhe marrim pjesë në takimet e tyre nga larg (webinar) dhe në vazhdimësi i njoftojmë për gjendjen në arsimin e Kosovës duke filluar nga çerdhet e deri në universitete. Në fillim të pandemisë në një takim nga larg të EI-së shtetet anëtare të saj njoftonin për gjendjen e krijuar pas pandemisë me Covid-19 në arsim dhe fillimin e mbajtjes së mësimin nga distanca. Në këtë takim i kam njoftuar për ndërprerjen e mësimin në objektet shkollore pas gjendjes së

pandemisë me Covid-19 të krijuar dhe fillimin e mbajtjes së mësimin nga distanca edhe në Kosovë.

Në takimin e fundit nga largësia të EI-së tema ishte “Rihapja e shkollave pas lehtësimit të masave parandaluese të virusit Covid-19”. Disa nga kushtet që duhet të plotësohen para rihapjes së institucioneve shkollore ishin:

1. Angazhimi në dialog shoqëror dhe politik.
2. Sigurimi i shëndetit dhe sigurisë së komuniteteve arsimore.
3. Barazia një përparësi kryesore.
4. Mbështetja e mirëqenies fizike dhe emocionale.
5. Besimi në profesionalizmin e mësimdhënësve.

Shumica e shteteve anëtare të EI-së mendonin që së pari të fillohet me rihapjen e çerdheve me qenë se fëmijët e vegjël kanë imunitet më të lartë ndaj virusit Covid-19 paraprakisht të përgatiten dhe të sigurohen kushtet për rihapjen e shkollave duke analizuar numrin e rasteve të mundshme të reja me covid-19, pastrimi dhe dezinfektimi i objekteve shkollore, pajisja e objekteve shkollore me mjetet parandaluese të përhapjes së virusit Covid-19, sigurimi i shëndetit të nxënësve dhe stafit punues, ndarja dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve në klasa.

Gjatë muajit

Takime nga larg me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve

Vlerësim i arritjeve, bashkëbisedë për angazhime e detyra të reja


Për të analizuar bashkërisht situatën aktuale në tërë sistemin arsimor të Kosovës dhe për t'u koordinuar për aktivitete e angazhime të reja, SBASHK-u ka mbajtur takime të shpeshta nga larg me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve. Në hapje të njërit prej këtyre takimeve kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka ftuar pjesëmarrësit për një minutë heshtje në shenjë respekti për punën dhe përkushtimin me vite e dekada në arsim dhe në

aktivitete sindikale të kolegut tonë të ndjerë Isuf Zenelaj nga Suhareka, i cili pa pritur u nda nga ne duke lënë kujtim të kolegët punën dhe përkushtimin në misionin e shenjtë për edukimin e brezave, por edhe në aktivitetet e shumta sindikale.

Në këto takime fillimisht kryetari Jasharaj ka bërë një analizë të rrjedhës së mësimin nga larg duke përgëzuar gjithë kolegët tanë për punën, përkushtimin dhe


Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

arritjet në realizimin e mësimi në distancë. Ai pas kësaj ka bërë vlerësimin edhe të organizmit të trajnimeve nga larg që po organizohen sipas kërkesave të anëtarësisë kudo në Kosovë. Kryetari Jasharaj ka lavdëruar angazhimet e stafit qendror dhe të trajnerëve të licencuar, që po mbajnë me sukses trajnimet me mësimdhënësit sipas kërkesave të tyre.




Kryetarët ve nivelit komunal dhe të Universiteteve në këto takime kanë treguar për situatën aktuale në arsimin duke treguar për punën dhe angazhimet e kolegëve tanë nëpër komuna për realizimin sa më me sukses të mësimi në distancë. Po ashtu edhe kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Universiteteve të Kosovës, Bardh Bardhi ka prezantuar në të gjitha këto takime angazhimin dhe përkushtimin e profesorëve në realizimin e ligjëratave nga larg me studentët duke u shprehur se vërtetë ata janë të përkushtuar e të angazhuar maksimalisht dhe se po realizojnë me përpikëri punën arsimore e studimore me studentët e të gjitha këtyre Universiteteve. Kryetarët në këto takime kanë përcjellë zërin e punëtorëve të arsimit nga komuna të tyre dhe të Universiteteve duke vlerësuar

lart angazhimet e SBASHK-ut në realizimin e kërkesave të anëtarësisë.




Me qëllim të koordinimit sa më të mirë të aktiviteteve është mbajtur edhe një mbledhje tjetër nga larg me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve. Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj ka ftuar pjesëmarrësit që me një minuta heshtje të lartësojnë kujtimin për kolegun tonë të ndjerë Agim Hoxha. Ai pas kësaj ka lutur kryetarin Kuvendit të Sindikatës së Arsimit parauniversitar të Prizrenit, Reshit Kushaj dhe kryesinë atje që të përcjellin te familja Hoxha ngushëllimet e sinqerta të SBASHK-ut.



Pas kësaj është bashkëbiseduar për përgatitjet që duhen bërë me kohë për realizimin me sukses të detyrave dhe aktiviteteve në vijim. Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj ka deklaruar se çështje për të cilën do të bashkëbisedohet në këta takim është edhe konsultimi lidhur me vazhdimin e traditës së mirë për dërgimin në bregdetin shqiptar të 400



kolegëve tanë nga e të Kosova dhe nga të gjitha nivelet e arsimit. “Jemi në një situatë të veçantë tani krijuar nga Covid 19, por urojmë që këtë betejë ta fitojmë ne dhe e gjithë bota. Ne duhet të bëjmë gjithë përgatitjet edhe për organizimin e pushimeve verore për një numër të kolegëve tanë kështu që me kohë t’i kemi të kryera gjithë detyrat dhe nëse krijohen mundësitë e kushtet ta realizojmë këtë traditë”, ka thënë kryetari Jasharaj, për të hapur pastaj debatin lidhur me çështjen e ngritur.



Menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri u ka prezantuar pjesëmarrësve të këtij takimi numrin e pushuesve nga secila komunë dhe Universitetet duke u bazuar në kriterin e përcaktuar nga organet gjegjëse të SBASHK-ut se në çdo 60 anëtarë caktohet një pushues. Ai ka kujtuar se për këtë duhet të mbahen takimet e Kuvendeve

Sindikale të Arsimit Parauniversitar dhe


Universiteteve për të caktuar se cilat shkolla e njësi akademike e kanë radhën të caktojnë pushuesit, kurse se kush janë pushuesit do të vendosin vetë anëtarët e SBASHK-ut nëpër shkollat dhe njësitë akademike gjegjëse.

Edhe në këtë takim është bashkëbiseduar për rrjedhën e trajnimeve dhe është vlerësuar se ato janë organizuar me sukses dhe se ka mjaft kërkesa nga anëtarësia për trajnime të reja.



Takime nga larg të EI-së me sindikatat anëtare nga e tërë bota

Bashkëveprim i angazhimeve në kohë të pandemisë



Internacionalia Botërore e Arsimit (EI) numëron 32 milionë anëtarë nga e tërë bota. Ajo ka vazhduar komunikimin nga larg me gjithë sindikatat anëtare me aëllim të angazhimit të nërbashkët dhe koordinimit të aktiviteteve në situatën e re të krijuar në tërë botën nga Covid 19. Në njërin prej takimeve të radhës

është bashkëbiseduar edhe nër idenë të disa shtete nër rihaniën graduale të institucioneve arsimore. Pjesë e këtij takimi ishte edhe SBASHK-u. nërfaqësuar nga nënkryetarja Vjollca Shala.

Takimin e hani dhe e udhëhoqi Presidentia e EI-së zni Susan Hongood e cila fillimisht nërshëndeti të nranishmit në takim nër të treguar nastai se në numër në rritje i vendeve no shavrtoinë lehtësimin e kufizimeve dhe gradualisht të rifilloinë arsimin në vend.” Internacionalia e Arsimit thekson një seri prei nesë dimensionesh që duhet të konsiderohen nga aeveritë. në dialog me arsimtarët dhe sindikatat e tyre. kur nlanifikoinë këtë fazë tietër të nërroiigies ndai virusit COVID- 19 të krizës në arsim” ka deklaruar kryetaria Hongood nër të numëruar nastai ato."Organizata Botërore e Shëndetit (ORSH) ka nxirrë në nah giashtë kushte që duhet të nërmbushen përpara se qeveritë të fillojnë të heqin kufizimet e

tanishme për lëvizjen sociale dhe fizike në lidhje me përhapjen e COVID-19:

Transmetimi i sëmundjeve është nën kontroll.

Sistemet shëndetësore janë në gjendje të "zbulojnë, testojnë, izolojnë dhe trajtojnë çdo rast dhe të gjurmojnë çdo kontakt".

Pikat e nxehta të rreziqeve të zvogëlohen në vendet në nevojë, siç janë shtëpitë e pleqve. Shkollat, vendet e punës dhe vendet e tjera thelbësore kanë krijuar masa parandaluese.

Rreziku i importimit të rasteve të reja "mund të menaxhohet".

Komunitetet janë plotësisht të arsimuar, të angazhuar dhe të fuqizuar për të jetuar nën një normalitet të ri", Ka veçuar ajo.

Sekretari I përgjithshëm i EI-së z. David Edvards tregoi për pesë strategjitë që duhet të ndërmarrin qeveritë për rihapjen e shkollave dhe atë :

1. Angazhimi në Dialog Social dhe Politik

Autoritetet publike të përfshihen në dialog të vazhdueshëm shoqëror dhe politik me arsimtarët dhe sindikatat e tyre përfaqësuese dhe organizatat për të vlerësuar nevojat dhe të bien dakord për masat shëndetësore dhe të sigurisë për studentët dhe stafin arsimor për kalimin përsëri në mësimdhënie dhe mësim në vend. Të përkushtohet vëmendja për ngarkesën shtesë të punës që rrjedh nga kërkesa paralele e mësimi ballë për ballë dhe në internet gjatë rihapjes graduale të shkollave. Të drejtat e punës së mësimdhënësve dhe personelit mbështetës të arsimit të respektohen dhe të ruhen kushte e përgjithshme në punë.

2. Sigurimi i Shëndetit dhe Sigurisë së Komuniteteve të Arsimit

Ekziston një marrëveshje dhe qartësi për masat higjienike të nevojshme për mbajtjen e fëmijëve studentëve dhe stafit të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe masat parandaluese për përmbajtjen e përhapjes së virusit. Të gjitha shkollat dhe institucionet arsimore

duhet të jenë të pajisura për të siguruar dhe mbajtur praktika të përmirësuara të higjienës dhe pastrimit.

3. Barazia të jetë përparësia kryesore

Barazia është qenësore në planet e tranzicionit, duke pranuar që ndikimi i pandemisë nuk është i barabartë dhe që tashmë studentët dhe punonjësit e arsimit në nevojë kanë qenë dhe mund të vazhdojnë të jenë më të prekurit. Të krijohet një strukturë mbështetëse për të gjithë studentët dhe stafin ,të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë qenë në gjendje të marrin pjesë në mësimin në internet ose në shtëpi. Një strategji është zhvilluar për adresimin e rritjeve të mundshme të niveleve të braktisjes, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vajzave dhe grave, dhe atyre që janë në rrezik të punës së fëmijëve.


4. Mbështetja e Mirëqenies fizike dhe emocionale dhe rikuperimi

Sistemet janë krijuar për të mbështetur mirëqenien dhe shëndetin mendor të fëmijëve, studentëve dhe stafit arsimor, përfshirë edhe përmes mbështetjes dhe këshillimit të përkushtuar psikosocial. Përveç pandemisë që shkakton stres dhe ankth të vazhdueshëm, shumë fëmijë, studentë dhe staf arsimor gjithashtu do ta kenë të vështirë të kthehen në shkollë dhe të përshtaten me rutinat e reja, si dhe kufizimet në bashkëveprimin shoqëror. Mbështetja e përkushtuar duhet të jetë në dispozicion për ata që mund të kenë pësuar vdekje në familje, abuzim, dhunë ose trauma të tjera emocionale.


5. Besimi në profesionalizmin e arsimtarëve

Autoritetet arsimore angazhohen me arsimtarët dhe sindikatat e tyre për të përcaktuar dhe vlerësuar ndikimin e mbylljeve të shkollës në mësimdhënie, mësimnxënie dhe mirëqenien e studentëve. Çdo kornizë për kalimin përsëri në arsimin në vend është e bazuar në besimin në profesionalizmin dhe praktikën pedagogjike të fuqisë punëtore arsimore. Qartësia për çdo kërkesë vlerësimi arrihet në dialog me mësimdhënësit dhe sindikatat përfaqësuese të tyre për të siguruar një trajtim të drejtë dhe të barabartë të të gjithë studentëve dhe pavarësinë e vazhdueshme profesionale të mësimdhënësve.

Duke bërë një përmbledhje të diskutimeve e deklarimeve të folësve të këtij takimi Presidentja znj.Hopgood është shprehur se në shkollat dhe institucionet arsimore të mbyllura në shumicën e vendeve, ka çështje kritike për të marrë në konsideratë qeveritë, pasi vendet gradualisht fillojnë të rihapin institucionet e fëmijërisë së hershme, shkollat dhe institucionet e arsimit të lartë. “Është e domosdoshme që qeveritë të komunikojnë në mënyrë transparente dhe të vazhdueshme në lidhje me planet për rihapjen e arsimit në vend dhe për shkallën në të cilën ata informohen me këshillat e ekspertëve të shëndetit. Dialogu i vazhdueshëm shoqëror dhe politik me arsimtarët dhe sindikatat e tyre është gurmtheli i çdo strategjie të suksesshme arsimore”, ka deklaruar kryetarja e EI-së, znj. Hopgood.



Edhe një takim nga larg me EI



“Vlerësimi i ndikimit të COVID-19 në edukimin e hershëm të fëmijëve dhe reagimet politike”

Takimin nga largësia (Webinar) e hapi Presidentja e EI znj.Susan Hopgood e cila fillimisht përshëndeti të pranishmit në takim. Përhapja e COVID-19 është një

krizë e shëndetit publik krejt ndryshe nga ç'do gjë që bota është përballur për shumë vite. Ndërsa personeli arsimor dhe sindikatat e tyre merren me shpërthimin, ne po mbështesim dhe informojmë organizatat anëtare në çfarëdo mënyre që mundemi.

Prej muajsh, sindikatat e arsimit janë mobilizuar pa u lodhur për të ju siguruar anëtarëve të tyre ndihmë dhe avokim, në emër të personelit arsimor, por edhe për të mirën e të gjithë komunitetit shkollor, për mbështetje të qartë të sektorit të arsimit në këto kohë krize të paparë.

Disa nga shtetet anëtare të EI -së në këtë webinar ndanë përvojat e tyre për ndikimin e COVID-19 në shtetin e tyre me theks të veçantë në edukimin e hershëm të fëmijëve. Një përvojë të tyre me të pranishmit në webinar e ndau Danimarka z.Lasse Bjerg Joergensen i cili tregoi se çerdhet atje janë hapur para 6 javëve pasi është bërë pastrimi dhe dezinfektimi i vazhdueshëm i objekteve. Është bërë ndarja apo zvogëlimi i numrit të fëmijëve me nga 6 fëmijë në grup.



Pjesmarrës në këtë takim ishin edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut të cilët në këtë webinar ndanë me të pranishmit këto informacione:

Të gjitha institucionet arsimore të kosoves duke filluar nga qerdhet e deri në universitet janë akoma të mbyllura. Mësimin në distancë të gjitha institucionet arsimore të ks e kanë filluar menjëherë pas javës së parë të mbylljes së tyre. Fëmijet e edukimit të hershem takimet nga distanca janë duke i mbajtur me mësueset dhe me prindërit e tyre të cilët po kryejn aktivitete të ndryshme.

Kryeministri në detyrë i Kosovës dhe Ministria e Arsimit kanë paralajmëruar se në fillim të qershorit ka gjasa të rihapen çerdhet.

Ministria e arsimit në ks është duke punuar në organizimin dhe mbajtjen e testit të arritshmërisë për

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

nxënësit e klasëve të 9 dhe testin e maturës për nxënësit e klasëve të 12. Janë duke u bërë përgaditjet që në institucionet arsimore testi i arritshmërisë të mbahet në fund të qershorit dhe testi i maturës në fillim të korrikut.

Disa nga kushtet që duhet të plotësohen para rihapjes së qerdheve dhe shkollave:

- Analizimi i numrit të mundeshum të rasteve të reja me covid-19
- Pastrimi dhe dezinfektimi i objekteve shkollore
- Paisja e objekteve shkollore me mjetet parandaluese të përhapjes së covid-19
- Sigurimi i shëndetit të fëmijëve dhe stafit punues
- Ndarja dhe zvogëlimi i numrit të fëmijëve në klasa.

Pjesëmarrësit pohuan vendosmërinë e tyre për të vazhduar luftën për arsimim publik cilësor për të

Organizim i suksesshëm i trajnimeve edhe me kolegët nga Dragashi


Kolegët nga kjo komunë kërkojnë të vazhdojnë me trajnimet tjera

Puna e palodhshme e stafit qendror dhe përkushtimi i trajnerëve kanë bërë që trajnimet e mbajtura të kenë rrjedhë të mbarë dhe kjo ka bërë jehonë pozitive të anëtarësia në të gjitha komunat. Ata kanë vazhduar të shtrojnë kërkesa për organizim të trajnimeve edhe për ta. Duke realizuar këto kërkesa u organizuan trajnime edhe për kolegët tanë nga komuna e Dragashit.




Fillimisht u nis me grupin e formuar për trajnim nga kolegët tanë të Gjinnazit të Dragashit. Trajnimin "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik më Arsimin Parauniversitar" e udhëhoqi prof. dr. Hysen Sogojeva. Ky trajnim përfundoi me sukses dhe pjesëmarrësit shprehën respekt për angazhimet e SBASHK-ut dhe për përkushtimin e trajnerit Sogojeva. Pas kësaj u

gjithë, dhe kushte të drejta, të sigurta dhe të shëndetshme për të gjithë personelin arsimor, gjatë dhe pas pandemisë aktuale globale.




organizua trajnimi "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror e demokratik" me trajnerin Sami Shala, ligjërues në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës.



Si çdo herë tjetër, edhe kësaj radhe, në hapje të këtij aktiviteti kryetari i SBASHK-ut ka përshëndetur kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë, Xhevit Skenderi, trajnerin Sami Shala, pjesëmarrësit dhe stafin qendror, që po vazhdon pa u ndalur në realizimin detyrave në shërbim të anëtarësisë. "Shpreh respekt meritore për trajnerin Shala, i cili krahas shumë angazhimeve në Universitet, po gjen kohë dhe po angazhohet edhe në



këtë aktivitet të SBASHK-ut. Falënderoj edhe trajnerin prof. dr. Hysen Sogojeva, i cili krahas shumë angazhimeve që ka si ligjërues i nderuar në Universitet, po gjen kohë të jap kontribut me vlerë edhe në aktivitetet e SBASHK-ut e veçmas në mbajtjen e trajnimeve me kolegët tanë kudo në Kosovë.



Përgëzoj edhe kolegët tanë në komunën e Dragashit dhe gjithë punëtorët e arsimit në Kosovë që po

Vullneti për njohuri të reja i kolegëve tanë për çdo respekt

Angazhime e aktivitete edhe në ditët e vikendit e të festës

Shumë nga mësimdhënësit e Kosovës, krahas angazhimeve të përditshme në mësimin nga larg, kanë shprehur kërkesën në SBASHK-u për organizimin e trajnimeve nga larg me qëllim të përvetësimit të njohurive të reja, të cilat do t'i vënë në jetë në procesin edukativ e arsimor. Me qëllim që të jenë të përkushtuar e në dispozicion të mësimin nga larg ata kanë dhënë idenë që trajnimet e licencuara të SBASHK-ut të organizohen edhe në ditë vikendi e feste. Ky vullnet i kolegëve tanë për njohuri të reja është për çdo respekt.



angazhohen në rrjedhën e mbarë të mësimin në distancë. SBASHK-u do të vazhdojë të jetë zë i anëtarësisë “, është shprehur kryetari Jasharaj, i cili edhe në këtë fjalë përshëndetëse ka vlerësuar lart dhe angazhimin e koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe gjithë stafit qendror në realizimin e detyrave konkrete, por edhe në plotësimin e kërkesave që vijnë vazhdimisht nga anëtarësia. Në hapje të këtij trajnimi nga larg kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit edhe nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe menaxheri për financa e administratë dhe koordinatort për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri duke iu përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve lidhur me rrjedhën e trajnimit dhe për çështje të caktuara sindikale, kurse kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Dragashin, Xhevit Skënderi, që ishte edhe pjesëmarrës i këtij trajnimi, ka shprehur respekt për punën, përkushtimin dhe arritjet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë.

Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror, krahas shumë angazhimeve tjera, kanë vazhduar me angazhimet për organizimin me sukses të shumë trajnimeve bazuar në kërkesat e anëtarësisë që vijnë në SBASHK përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal.




Pjesëmarrësit e këtyre trajnimeve për të qenë në nivel të detyrës në mësimin nga distanca kanë arritur marrëveshje me stafin qendror dhe me trajnerët për orarin e mbajtjes së trajnimeve gjegjëse duke e respektuar atë në përpikëri. Kjo ka bërë që trajnimet

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

dhe "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm". Këto trajnime kanë nisur me një dallim kohorë prej 15 minutash me qëllim që kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala, koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe anëtarë të tjerë të stafit qendror të jenë të kyçur e për të bashkëbiseduar me pjesëmarrësit e këtyre trajnimeve.

Kryetari i SBASHK-ut në të gjitha kyçjet u ka thënë pjesëmarrësve se është për çdo lëvdatë angazhimi e përkushtimi i kolegëve tanë kudo në Kosovë në mësimin nga larg dhe se është për t'u lavdëruar edhe gatishmëria dhe kërkesa për pjesëmarrje në trajnimet e licencuara të SBASHK-ut. Në këto kyçje stafi i SBASHK-ut është shoqëruar edhe nga kryetarët e nivelit komunal, të cilët kanë përgëzuar pjesëmarrësit nga komunat e tyre në këtë aktivitet dhe kanë përgëzuar SBASHK-un për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë. Gjatë këtyre bashkëbisedave pjesëmarrësit kanë shtruar edhe pyetje konkrete lidhur me rrjedhën e trajnimeve dhe për çështje sindikale. Në këto pyetje është përgjigjur koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.




SBASHK-u i përkushtuar për rrjedhën e mbarë të trajnimeve


Takime e konsultime të vazhdueshme me trajnerët e licencuar



Krahas angazhimeve në procesin arsimor nga larg, shumë nga anëtarët e SBASHK-ut kanë drejtuar




Kryetari i SBASHK-ut dhe stafi qendror ka shprehur respekt meritot për trajnerët Alban Zeneli, Muhamet Jahiri, Minire Terbunja, Besim Haliti, Besjana Rexhepi, Atdhe Hykolli, Pranvera Haziri, Ramadan Gashi, Jehona Oruqi, Valentina Sopjani, Safet Beqiri, Besim Kryeziu, Hysen Sogojeva, Arbenita Hoxha, Sami Shala, Besim Haliti dhe Besjana Rexhepi të cilët kanë dhënë kontribut të çmuar në rrjedhën e mbarë të trajnimeve.



kërkesa përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal për organizimin e të pesë trajnimeve të licencuara të SBASHK-ut. Stafi qendror i ka përkrahur këto kërkesa dhe me qëllim të organizimit sa më të mirë të këtij aktiviteti ka ftuar në takime nga larg trajnerët e licencuar për të bashkëbiseduar me ata e për të parë gatishmërinë e tyre për angazhime në rrjedhën e mbarë të trajnimeve.





“Trajnimet nga larg kishin nisur të organizohen me kolegët tanë nga Novobërda dhe falë përkushtimit të trajnerëve të angazhuar në këto trajnime kolegët tanë nga kjo komunë kanë vazhduar me mëkresat për trajnimet e radhës. Kërkesa të tilla të shumta kanë ardhur edhe nga Prishtina dhe komunat tjera dhe prandaj ju kemi ftuar në këtë takim që të bashkëbisedojmë dhe të shohim gatishmërinë tuaj për t’u angazhuar në trajnimet e radhës me kolegët tanë nga e tërë Kosova”, u është drejtuar trajnerëve pjesëmarrës në takimin nga larg, kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj. Trajnerët pjesëmarrës në takim janë shprehur të gatshëm që të angazhohen në trajnime duke premtuar se do të jenë të përkushtuar dhe do të japin kontribut në rrjedhën e mbarë të trajnimeve , në të cilët do të jenë të angazhuar.




Nënkryetarja Vjollca Shala dhe menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë dhënë sqarime lidhur me mënyrën e organizimit të trajnimeve nga larg duke u nisur nga listat e pjesëmarrësve, mbajtja e shënimeve për vijueshmërinë dhe detaje të tjera. Ata janë shprehur se stafi qendror do të jetë i angazhuar gjatë gjithë kohës për të ndihmuar e për të kontribuar në rrjedhën e mbarë të trajnimeve. Në vazhdim të këtij takimi trajneri prof. dr. Hysen Sogojeva ka përgëzuar fillimisht SBASHK-un për gjithë arritjet në shërbim të anëtarësisë dhe për organizimin e këtyre trajnimeve nga larg duke vlerësuar se kjo është një dëshmi e përkushtimit të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim. Ai është shprehur i gatshëm që të angazhohet edhe në të ardhmen në trajnimet me kolegët tanë nga e tërë Kosova. Gatishmërinë për të kontribuar në rrjedhën e mbarë të trajnimeve nga larg e kanë shprehur edhe gjithë trajnerët tjerë pjesëmarrës.



Pas kësaj është zhvilluar një bashkëbisedë mes trajnerëve dhe stafit qendror duke dhënë ide lidhur me punën që duhet bërë gjatë trajnimeve me qëllim që sukcesi të jetë sa më i lartë dhe të arrihen objektivat e trajnimeve. Po ashtu janë këmbyer ide për përvojat e trajnerëve gjatë mbajtjes së trajnimeve nga larg. Trajnerët pjesëmarrës në këtë takim kanë shtruar edhe pyetje që ndërlihdeshin me trajnimet që do të nisin tani e tutje.

Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri është përgjigjur në pyetjet e shtruar lidhur me rrjedhën e mbarë të trajnimeve duke shtuar se stafi qendror do të vazhdojë të mbështes trajnerët dhe pjesëmarrësit në kyçjet nga larg. “Kyçjet në trajnime


të kryetarit Jasharaj dhe të stafit qendror janë pikërisht për t'u dhënë mbështetje në rrjedhën e mbarë të trajnimeve e jo për të përcjellë punën tuaj, sepse ne kemi besim të plotë të ju e këtë besim ju e keni krijuar me punën e përkushtimin gjatë trajnimeve me kolegët tanë kudo në Kosovë”, ka deklaruar Ymeri. Pas kësaj janë caktuar trajnerët që do të angazhohen fillimisht dhe është koordinuar orari i mbajtjes së trajnimeve, për të cilat kanë arritur kërkesat nga kolegët tanë.



Agjenda e re e takimeve nga larg me nivelin sindikal komunal dhe Universiteteve


U fillua me Kuvendin e Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Prishtinës

Takimin e shpalli të hapur kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit parauniversitar të Prishtinës, Ahmet Pllana, i cili ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe pastaj ka treguar se në takimin nga larg me kryetarët e Kuvendeve të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar dhe Universiteteve është zhvilluar një bashkëbisedë për të vlerësuar arritjet deri tani dhe po ashtu janë caktuar edhe detyra konkrete për të ardhmen. Kryetari Pllana ka lavdëruar angazhimet e kryetarit të SBASHK-ut dhe stafit qendror në shërbim të anëtarësisë dhe pastaj ka bërë edhe një shpalosje të arritjeve në organizimin e mirë të trajnimeve duke treguar se ky aktivitet është pritur mirë dhe gjithë trajnimet kanë pasur rrjedhë të mbarë falë angazhimit të stafit qendror, trajnerëve dhe përkushtimit të pjesëmarrësve, të cilët janë angazhuar maksimalisht edhe kur trajnimet janë organizuar edhe gjatë ditëve të vikendeve e festave.




Pas kësaj kryetari i SBASHK-ut ka përshëndetur pjesëmarrësit e këtij takimi nga larg duke i përgëzuar për angazhimin e vazhdueshëm në realizimin e

mësimit në distancë dhe për aktivitetet e realizuara sindikale. Ai ka përmendur se në takimin e kaluar konsultativ me kryetarët e nivelit komunal e të Universiteteve është bërë analiza aktuale e gjendjes në arsim me theks të veçantë në rrjedhën e mësimit nga larg dhe është vlerësuar nga të gjithë se punëtorët e arsimit, gjegjësisht anëtarët e SBASHK-ut gëzojnë respekt meritore për angazhimin dhe arritjet në realizimin me sukses të mësimit në distancë. Kryetari Jasharaj ka cekur se në atë takim është bashkëbiseduar edhe për vendimin nga takimi përmbyllës i vitit 2019 i Këshillit Drejtues, që të vazhdohet me realizimin e traditës së mirë edhe këtë vit, gjegjësisht për të organizuar edhe në verën e vitit 2020 pushime për një numër të anëtarëve tanë në bregdetin shqiptar. Pas kësaj ka nisur bashkëbiseda e pjesëmarrësve në të cilën kanë marrë pjesë edhe nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe menaxheri për financa e administratë e koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.




Pjesëmarrësit kanë bërë një analizë të trajnimeve të organizuara për kolegët tanë nga kjo komunë dhe kanë

vlerësuar lartë angazhimin e SBASHK-ut dhe përkushtimin e trajnerëve. Ata kanë vlerësuar si shumë të suksesshme dhe fort të rëndësishme këto trajnime, të cilat po ndihmojnë shumë kolegët tanë në marrjen e njohurive të reja nga lëmi të caktuara. Shumica prej kryetarëve të shoqatave sindikale të shkollave pjesëmarrëse në këtë takim kanë kërkuar nga stafi qendror i SBASHK-ut që të vazhdohet me trajnime për punëtorët arsimor të Prishtinës sepse, si thanë ata, ka shumë kërkesa për një aktivitet të tillë. Koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri ka theksuar se stafi qendror do të bëjë gjithë të mundurën për organizimin e trajnimeve për kolegët nga e tërë Kosova, pra edhe për mësimdhënësit e nderuar nga Prishtina.



Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Prishtinës, Ahmet Pllana pas kësaj ka kaluar në pikën e radhës së rendit të ditës dhe ka treguar se duhet bërë përgatitje për realizimin e një aktiviteti tjetër të SBASHK-ut në nivel vendi, gjegjësisht për të dërguar një numër të konsideruar të kolegëve tanë nga e tërë Kosova për pushime në bregdetin shqiptar. Ai ka kujtuar se vendim i organeve të SBASHK-ut bazuar në mundësitë materiale është

që në çdo 60 anëtarë dërgohet një anëtar në det. Ai pas kësaj ka treguar për kriteret e përzgjedhjes së shkollave që do të caktojnë pushuesit, ndërsa, si tha ai, caktimin e pushuesve nga shkollat gjegjëse e bëjnë anëtarët tanë atje duke mbajtur takim nga larg e duke u pajtuar se kush do të shkojë në pushime këtë vit nga shkolla e tyre. Në vazhdim të kësaj bashkëbisede kryetari Pllana bashkë me pjesëmarrësit kanë diskutuar për shkollat dhe institucionet tjera arsimore që janë në radhë për të përcaktuar pushuesit duke u kujdesur edhe për respektimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrësit kanë arritur marrëveshje një zëri për këtë.



Në vazhdim të këtij takimi pjesëmarrësit kanë shtruar pyetje lidhur me çështje të ndryshme sindikale dhe në to është përgjigjur menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

Ishte mendim i përbashkët i pjesëmarrësve dhe stafit qendror që me takime të tilla nga larg të vazhdohet me qëllim që të bashkëbisedohet dhe të merren bashkërisht vendime për angazhime dhe veprime konkrete në shërbim të realizimit të kërkesave të anëtarësisë.